



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 prill 2012
Nr. ref.: RK150 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 77/11

Parashtruesi

Mustafa Mazreku

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.nr.330/2008, të datës 06.01.2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mustafa Mazreku nga Mamusha, me banim në Prizren, rruga 'Selver Maçkaj' nr. 8, të cilin e përfaqëson avokati Masar Pirana, nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohet se janë bërë shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, i datës 06.01.2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 8 qershor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, të datës 6 janar 2011, të cilin parashtruesi i kërkesës, sipas pohimit personal, e ka pranuar më 22.02 .2011.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 08.06.2011, Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e z. Mustafa Mazreku dhe e regjistroi atë me Nr. KI 77/11.
6. Më 17 gusht, me vendimin GJ.R 77/11, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren dr. Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese.
7. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Almiro Rodrigues e Prof. dr Enver Hasani, anëtarë të kolegjit.
8. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës, si dhe parashtruesin e kërkesës, për regjistrimin e lëndës më 24 qershor 2011, por në afatin ligjor nuk ishte marrë asnjë koment nga asnjëra palë.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 1 tetor 1987, z. Mustafa Mazreku ka themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar në Shkollën fillore "Fadil Hisari" në Prizren në vendin e punës **Arkëtar**, dhe këtë në bazë të Aktvendimit për "Bashkimin e mjeteve dhe punës" nr. 256, të datës 01 tetor 1987, dhe në këtë vend pune kishte punuar pandërprerë deri pas lufte dhe me themelimin e Administratës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).
10. Më 7 gusht 2000, UNMIK-u kishte nxjerrë "Direktivat e Departamentit të Arsimit dhe Shkencës"-Kontratat e punësimit për periudhën 1/9/00 deri më 31.12.00, dhe kishte caktuar kushtet nën të cilat punëtorët arsimorë mund të marrin kontratat e punësimit, kushtet për kontrata të përkohshme për mësuesit, si dhe kushtet për pagesë të atyre që do të punojnë por nuk do të kenë kontrata punësimi për periudhën kohore të cekur në këtë direktivë.

11. Sipas pohimit të z. Mustafa Mazreku, në përputhje me këtë direktivë atij nuk i është dhënë kontrata e punës, edhe pse sipas listës së pagave ai ka marrë avancën në të holla në shumën prej 450 DEM për muajt IX, X, dhe XI të vitit 2000.
12. Gjithashtu sipas pohimit të tij, ai pos që nuk kishte marrë kontratën e punës nuk kishte marrë as 800 DEM shpërblim për ata që kishin mbetur pa kontrata pune dhe të papunësuar. Ndërkohë, kur të gjithë të punësuarit e kësaj shkolle me kontrata pune kishin marrë diferencën e pagës për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2000, ai nuk e kishte marrë këtë diferencë e as pagën e plotë për muajin dhjetor 2000. Megjithatë, z. Mazreku ka vazhduar të shkojë vazhdimisht në punë edhe pse pa kontratë punë dhe pa të ardhura personale.
13. Më 29janar 2002, duke parë se situata në të cilën gjendej nuk zgjidhej, z. Mustafë Mazreku ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren duke kërkuar zgjidhjen e kontestit të punës.
14. Më 8 maj 2007, Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerr Aktgjykimin C. nr. 112/06, me të cilin **aprovon si të bazuar** padinë e paditësit, z. Mustafë Mazreku, dhe **obligon** Komunën e Prizrenit - Drejtoratin për Arsim dhe Shkencë që paditësin ta kthejë në vendin e punës Arkëtar në Shkollën fillore "Fadil Hisari" me të gjitha të drejtat që i ka pasur deri më 1 tetor 2001.
15. Më 2 qershor 2008, duke vendosur sipas ankesës së Komunës së Prizrenit–Drejtoratit Komunal, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin AC.nr.296/2007, ka refuzuar si të pabazuar këtë ankesë dhe Aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komunale C.nr.112/06 e kishte lënë në fuqi.
16. Meqenëse aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës së Qarkut në Prizren nuk po zbatohet, z. Mustafa Mazreku ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarrimin e këtij aktgjykimi, dhe kjo Gjykatë, me Aktvendimin E.nr.1063/08, ka aprovuar këtë kërkesë ndërsa me 10.10.2008 ka bërë edhe ekzekutimin e tij duke e kthyer në punë z. Mustafë Mazrekaj.
17. Në fakt, edhe pse Gjykata Komunale e kishte ekzekutuar vendimin e vet, z. Mazrekaj vetëm fizikisht kishte shkuar në punë sepse atij nuk iu dha ndonjë kontratë pune por vetëm iu premtua se do t'i ofrohet vendi i punës i bibliotekarit pasi që vend pune për arkëtar nuk ka, jo vetëm në shkollën "Fadil Hisari" por në asnjë shkollë tjetër, pasi që tashmë mjetet financiare nuk menaxhohen nga shkollat por nga Drejtoria Komunale për Arsim dhe Shkencë. Z. Mustafë Mazreku ka vazhduar të shkojë në punë në shkollën fillore "Fadil Hisari" edhe për 5 muaj rresht pas kthimit në punë nga Gjykata Komunale por pa të ardhura personale, dhe pas kësaj ka vendosur të mos shkojë më në punë deri sa të zgjidhet kontestit i tij i punës.
18. Më 25 qershor 2008, Avokatura Publike e Komunës së Prizrenit ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës me të cilin ka atakuar aktgjykimet e Gjykatës Komunale të Prizrenit (C. Nr. 112/06, i datës 08.05.2006) dhe të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (AC. nr 296/2007, i datës 02.06.2008), dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së Drejtës materiale.
19. Më 08.07.2009, Gjykata Komunale në Prizren, si Gjykatë përmbarrimore, ka nxjerrë Aktvendimin E.nr.1063/08 me të cilin ka gjobitur Drejtorin e Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë të Komunës së Prizrenit, në cilësinë e personit përgjegjës, me 50 Euro dhe Drejtorinë për Arsim dhe Shkencë, në cilësinë e personit juridik, me 200 Euro për shkak të moszbatimit efektiv të vendimit të përmbarrueshëm.

20. Më 6 janar 2001, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të Avokaturës Publike të Komunës së Prizrenit, mori Aktgjykimin Rev 330/2008 me të cilin aprovoi revizionin e paraqitur dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 112/06, të datës 08.05.2006 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren AC. Nr. 296/2007, të datës 02.06.2008 në atë mënyrë që padia e z. Mustafë Mazreku REFUZOHET. Këtë Aktgjykim z. Mustafë Mazreku e kishte pranuar më 22.02.2011.
21. Gjykata Supreme në aktgjykimin e revizionit të saj kishte theksuar se gjykatat e rregullta të rangut më të ulët kishin vërtetuar drejt gjendjen faktike, por kishin bërë **gabimisht aplikimin e të drejtës materiale** pasi që me direktivat e UNMIKUT marrëdhënia e punës në institucionet arsimore ka qenë marrëdhënie kontraktuale dhe e lidhur me afate kohore. Ndërsa pasi që zoti Mazreku nuk ka pasur kontratë pune ai nuk ka pasur as marrëdhënie juridike pune valide por vetëm punë faktike në shkollë.
22. Menjëherë pasi kishte marrë aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Komunës së Prizrenit për aprovimin e revizionit, z. Mustafë Mazreku nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit z. Masar Pirana nga Prizreni, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit në Prishtinë.
23. Më 31 mars 2011, Prokuroria e Shtetit, me shkresën zyrtare KMLC nr 23/2011, kishte njoftuar z. Mustafa Mazreku se në bazë të dispozitës së nenit 245.3 lidhur me nenin 220 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë NUK LEJOHET kundër vendimit të marrë me rastin e revizionit nga Gjykata Supreme, andaj edhe në këtë rast kjo kërkesë nuk mund të ngritet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. Nr. 330/2008, të datës 06.01.2011, ia ka mohuar të drejtën për punë të cilën përndryshe Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C. Nr. 112/06, të datës 08.05.2007, dhe Gjykata e Qarkut, gjithashtu në Prizren, me Aktgjykimin AC. Nr. 296/07, të datës 02.06.2008, ia kishin njohur.
25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 24.1 (Barazia para ligjit); neni 31.2 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm); neni 102.3 (Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit); neni 49 (E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit), si dhe është shkelur **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**, neni 7 (Barabarësia para ligjit pa asnjë lloj diskriminimi). Gjithashtu sipas pohimit të paraqitësit të kërkesës është shkelur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 7, si **dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial** (nenet 2.1, 5 dhe 6).

Vlerësimi për pranueshmëri të kërkesës

26. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë që përcaktohen me Kushtetutë.
27. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar”.

28. Duke iu referuar shkeljes së supozuar, nga ana e parashtruesit të kërkesës, të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të konventave e instrumenteve tjera ndërkombëtare, në cilësinë e Gjyqtarit raportues konstatoj:
29. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pika 3. të Kushtetutës është qartazi e paraparë: **"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."**
30. Në nenin 103 [**Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave**] të Kushtetutës, në pikën 2 është gjithashtu qartazi e përcaktuar: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor."
31. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk gjen asnjë fakt se Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës për revizion, për të cilën shprehimisht është e autorizuar në bazë të nenit 212 të LPK-së, të ketë shkelur nenin 31.2 (E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm), nenin 49 (E drejta për punë) apo nenin 102.3 (Gjykatat gjykojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit), që parashtruesi i kërkesës ka supozuar se janë shkelur.
32. Në fakt parashtruesi i kërkesës, përpos shprehjes së mos kënaqësisë për revizionin e nxjerrë nga Gjykata Supreme, nuk ka ofruar asnjë fakt tjetër të bazuar që gjykimi "nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm" dhe nuk ka shpjeguar se në cilën mënyrë ai ka qenë i trajtuar si i pabarabartë apo cila fazë e procedurës ka qenë jokushtetuese.
33. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i Gjykatës Kushtetuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantoohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
34. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
35. Gjykata Kushtetuese nuk mund të neglizhojë faktin se me direktivat e UNMIK-ut, por më vonë edhe me Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës - me nenin 1 të saj, të gjithë të punësuarit që marrin rrogë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, pra edhe të punësuarit në arsim, kishin statusin e nëpunësve civilë.
36. Kjo rregullore, në nenin 3.1(c), kishte paraparë "Që punësimi në Shërbimin civil të rregullohet me anë të kontratave me shkrim të punësimit", dhe në nenin 3.3 që

kontratat e punësimit në Shërbimin civil do të jenë për një periudhë kohore deri në tri (3) vjet dhe ato mund të vazhdohen.

37. Këto direktiva, por edhe kjo rregullore në fuqi në atë kohë, pa dyshim se marrëdhënien e punës e kanë definuar si kontraktuale dhe se sistemit të kontratave të punës i janë nënshtruar të gjithë shërbyesit civilë pa asnjë përjashtim, andaj Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës, z. Mustafa Mazreku, së bashku me kërkesën e tij në këtë Gjykatë nuk ka paraqitur asnjë kontratë të punës me shkollën “Fadil Hisari”.
38. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka “Gjykuar drejt dhe paanshëm” duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
39. Bazuar në këto rrethana, rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese duke e çmuar kërkesën si qartazi të pabazuar nuk deklarohet lidhur me shkeljen eventuale të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (neni 7) dhe as të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 7), që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Sistemin Juridik të Kosovës, e që sipas z. Mazreku pretendohet të jenë shkelur.
40. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”, andaj Kolegjit shqyrtues i propozoj që përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.2 (c,d) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 5 tetor 2011, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani